



SHKOLLË VERORE PËR FILOZOFI DHE POLITIKË - ITALI

Instituti i Shkencave Humane (IWM) fton studentë të diplomuar dhe hulumtues të rinj shkencor nga shkencat humane/sociale për pjesëmarrje në shkollën verore të fokusuar mbi temën: *“Religjioni dhe Sekularizmi”*.

Programi i shkollës verore përbëhet nga 4 seminare:

- “Religjioni dhe moderniteti i shumanshëm”
- “Religjioni dhe demokracia”
- “Roli i besimit në diskutet publike”
- “Zoti në debatet bashkëkohore”

Organizimi:

Pjesëmarrësit janë të obliguar të regjistrohen të paktën në 3 seminare. Seminaret do të zhvillohen në gjuhën angleze dhe pjesëmarrësit detyrimisht duhet të zotërojnë shkëlqyeshëm gjuhën angleze. Seminari do të organizohet në Cartona të Italisë nga data 04 - 17 Korrik 2010.

Shpenzimet:

Nuk ka pagesa për ndjekjen e kësaj shkolle verore; materialet e seminareve, banimi dhe ushqimi janë të mbuluara nga organizatorët, ndërsa pjesëmarrësit duhet të mbulojnë shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet tjera të pa parashikueshme.

Procedura e aplikimit:

- formular aplikimi - (http://www.iwm.at/info/Summerschool_2010_Apl.doc)
- biografi të shkurtër - (CV)
- letër motivimi - (në të cilën duhet të trajtohet të paktën njëra nga temat e seminarit, maksimumi deri në 5 faqe)

Aplikimet duhet të dërgohet në gjuhën angleze më së voni deri më **25 MARS 2010** nëpërmjet adresës elektronike: summerschool@iwm.at

Për më shumë informacione drejtohuni në Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë - QeSHK.